

**VENDIM**  
**Nr.42, datë 14.7.2006**

**PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT PËR APLIKIMIN PËR  
NDËRTIMIN DHE INSTALIMIN E NJË H/C TË RI NGA SHOQËRIA REMI SHPK**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1 germa a, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.4.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 7, të ligjit nr.7973, datë 25.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” me ndryshimet përkatëse, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” me ndryshimet përkatëse, neni 11; vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 14.10.2004 “Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale”, neni 9, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.7.2006, pasi shqyrtoi aplikimin për ndërtimin dhe instalimin e një H/C të ri nga shoqëria REMI sh.p.k., konstatoi se shoqëria Remi sh.p.k.:

- nuk ka paraqitur vendim të Këshillit të Ministrave për miratim të marrëveshjes së koncensionit të formës BOO si propozim i pakërkuar,

- nuk ka paraqitur në ERE leje të ndërtimit nga organet kompetente përkatëse të pushtetit vendor.

Në analizë të sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

**VENDOSI:**

1. Mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për ndërtimin dhe instalimin e një H/C të ri nga shoqëria REMI sh.p.k., pasi kjo kompani nuk ka përfunduar procedurat e marrjes në koncension dhe marrjes së lejes së ndërtimit nga organet kompetente të pushtetit vendor.

2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Licencave dhe Monitorimit të njoftojnë shoqërinë Remi sh.p.k. mbi vendimin e Bordit të Komisionerëve dhe mangësitë në dokumentacionin e dërguar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**